



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:037522  
Datë: 21.02.2025  
Numri i dokumentit: 06885430

**P.nr.321/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal**, Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrje e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.P, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së*”, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë PP/II.nr.1764/2023 të datës 05.04.2024, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar me datën 05.02.2025, të hapur për publikun, në prezencën e Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit A.P, si dhe mbrojtësit të tij av.Agim Haxhijaj, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 07.02.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.02.2025, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**A.P**, i lindur me datë ....., në Pejë, rr. “.....”, nr..., ku edhe tani jeton, nga i ati I. dhe e ëma N., e lindur ....., i martuar, baba i .... fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, me profesion ....., i gjendjes së mesme ekonomike, posedon nr. tel ....., i identifikuar në bazë të nr. personal ID-....., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

*Me dt.26.07.2023, rreth orës 17:35, në Rr.”.....”, në Pejë, pikërisht afër lokalit ..... rrezikon trafikun publik duke shkelur, nenin 227 lidhur me nenin 255 të Ligjit rregullat e trafikut rrugor nr.05/I-088 duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë, që nën ndikimin e alkoolit 1.13 promil, duke drejtuar motoçikletën me katër rrota të markës “.....”, pa targa të regjistrimit, me ngjyrë ..... në rrugën të ndaluar për qarkullim të gjitha automjeteve me veprim motorik shkakton aksident trafiku ku si pasoj me pjesën përparme ballore të motoçikletës godet tani të dëmtuarin A.N, e cili në momentin kritik ishte i ulur në karrige jashtë lokalit, me ç’rast si*

rezultat i këtij aksidenti lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari A.N, lëndime të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të ekspertit mjeko-ligjor Dr. Vesa Kotorri e dt.10.10.2023.

- Me këtë ka kryer veprën penale “*Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur*” nga neni 371 parag.2 e lidhur me parag.1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 79 dhe 371 par.2 dhe par.1 të KPRK-së, dhe neneve 240, 241, 242 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, 364, 365, 449, 450, 452 paragrafi 1 dhe 462 paragrafi 2 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej njëmijë e pesëqind (1500) euro, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor prej dyzetetë (48) orësh, duke filluar nga data 26.07.2023 e deri me dt.28.07.2023, ku një ditë e ndalimit i llogaritet në shumën prej njëzetë (20) euro, saktësisht shuma prej dyzetë (40) euro, me ç’rast i njëjti obligohet që të paguajë shumën prej një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë (1460) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguajë brenda afatit prej tre (3) muajsh, nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri, nuk dëshiron, refuzon ose nuk mund ta paguajë gjobën e cekur si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata do të e zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro gjobë, do ti llogariten barabartë me një (1) ditë burgimi.
- III. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, refuzon ose nuk mund të paguajë gjobë në tërësi, gjykata do të e zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës në dënim me burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
- IV. **OBLIGOHET**, i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- V. I dëmtuari A.N, me vendbanim në rr.“.....” nr....., në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datën 05.04.2025, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/II.nr.1764/2023, kundër të pandehurit A.P, nga Peja, për shkak të

veprës penale “*Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur*” nga neni 371 paragrafi.2 e lidhur par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 05.02.2025, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit Lumturie Hoxha, nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri A.P, si dhe mbrojtësi i tij av.Agim Haxhijaj, nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të pandehurit gjykata i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore konform nenit 241 paragrafi 1 të KPPRK-së, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur së i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të plotë dhe pa kurrfarë presioni ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “*Ngasje në gjendje të paaftë apo te dehur*” nga neni 371 paragrafi 2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç’rast Prokurorja e Shtetit deklaroi se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit A.P, av.Agim Haxhijaj, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bere në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës, pas shpjegimit të pasojave dhe privilegjeve të pranimit të fajësisë, kërkojë nga gjykata që ky pranim fajësie të aprovohet.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par.2 nën par.2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjene mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti fillestar i incidentit me nr.2023-DA-1170 e dt.26.07.2023 nga H.Z CP 11402, Raporti i Oficerit H.Z KPS 11402 e dt.26.07.2023, Procesverbali mbi vend-shikimin e aksidentit e dt.26.07.2023, Raport Informues nga rreshter F.M e dt.26.07.2023, Deklarata e dëshmitarit B.P e dhënë në Stacionin Policor Pejë me dt.26.07.2023, Deklarata e të dëmtuarit A.N e dhënë në Stacionin Policor Pejë me dt.26.07.2023, Deklarata e të dyshuarit A.P e dhënë në Stacionin Policor Pejë me dt.28.07.2023, Raporti Mjekësor nga Emergjencia e Spitalit të Përgjithshëm në Pejë me nr.14740 e dt.26.07.2023, Raporti i aksidentit i dt.26.07.2023 nga polici H.Z, Ekspertiza mjeko-ligjore e dt.10.10.2023, Fotot të motoçikletës së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që në bazë të nenit 242 par. 6 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit konform nenit 356 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për një seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën duke i ftuar palët që të deklarohen në fjalën e tyre lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit.

Prokurorja e Shtetit Lumturie Hoxha, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave rënduese ia lë në vlerësim gjykatës ndërkaq si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë.*

Mbrojtësi i të pandehurit A.P, av.Agim Haxhijaj, ka deklaruar se: *pajtohem me deklarimin e prokurores sa i përket rrethanave lehtësuese, për me tepër theksoj se i pandehuri përpos pranimin të fajësisë para gjykatës, i njëjti i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe është pajtuar, po ashtu i kërkojmë gjykatës që ta marr parasysht se i njëjtit është familjar, mbajtës i familjes, është i penduar për veprimet që i ka kryer, dhe asnjëherë nuk ka kryer veprë penale të tilla, andaj me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin i propozoj gjykatës që të njëjtit të shqiptoj një dënim me gjobe në proporcion me të ardhurat e tij të ultë, po ashtu edhe duke marr parasysht se i njëjti nga paga e tij mban edhe familjen e tij.*

I pandehuri A.P, ka deklaruar se: *i kam kërkuar falje të dëmtuarit, kam qene në lokalit të cilin ai punon, jam penduar për veprën penale që e kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të tilla.*

Prandaj me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja faktike e cila është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur*” nga neni 371 paragrafi.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit si rrethana lehtësuese ka marrë parasysht faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohet, është penduar si dhe premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale po ashtu si rrethanë lehtësuese gjykata morri për bazë edhe faktin se i njëjti është familjar dhe mbajtës i familjes, ndërkaq si rrethana rënduese gjykata mori për bazë faktin së sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.17/24, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 11.09.2024, i pandehuri është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “*Kanosje*” nga neni 181 par. 2 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit i është shqiptuar dënimi më burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjatë periudhës së

verifikimit prej 2 (dy) vitesh nuk kryen vepër tjetër penale. Andaj, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar me gjobë është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.3 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Ndërkaq, në përputhje me dënueshmërinë e përcaktuar sipas nenit 371 par.2 të KPRK-së, për veprën penale “*Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur*”, sipas të cilit përcaktohet se: *Kushdo që drejton automjetin në gjendje të paaftë apo nën ndikim të alkoolit nëse në gjak ka alkool mbi 0,5 g/kg respektivisht me sasi përkatëse në miligram për litër të ajrit të nxjerrë apo të substancave tjera dehëse nëse shkaktohet aksident dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet*”. Sipas paragrafit 2, të këtij neni përcaktohet se: *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”*.

Andaj, vendimin mbi dënimin e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shqiptimin e dënimit me gjobë, gjykata e mori në kuptim të nenit 43 të KPRK-së, ku me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij dhe i njëjti obligohet ta paguaj gjobën e lartcekur brenda periudhës së përcaktuar kohore si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për llogaritjen e ndalimit të të pandehurve për dyzetetë (48) orë në dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 79 par.4 të KPRK-së, i cili shprehimisht parasheh se: *“Një (1) ditë paraburgim, një (1) ditë heqje lirie, një (1) ditë burgim dhe njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni”*.

Ndërsa, vendimi si në pikën II dhe III të dispozitivit për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron që ta paguajë dënimin e shqiptuar me gjobë është marrë konform nenit 43 par. 3 dhe par. 4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A.N, me vendbanim në rr.“.....” nr....., në Pejë, realizimin e kërkesës pasurore juridike, e në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Andaj gjykata mbi bazën e të dhënave si me lartë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 364, 449, 462 të KPPK-së u vendos si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM.  
P.nr.321/24, me datën 21.02.2025.**

**Bashkëpunëtore profesionale:**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese:**

\_\_\_\_\_  
**Leonita Lajçi-Muçaj**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KELMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.